

Për:	Operatori Ekonomik: "TRIANGLE" Sh.p.k. me adresë në Suharekë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit 
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	17.06.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim**, të datës: **16.06.2021**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: "TRIANGLE" Sh.p.k. me adresë në Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RIPARIMI I OBJEKTEVE TË GJENDJES CIVILE**, me Numër të prokurimit: **623-21-1816-5-2-1**, Nr. i brendshëm: **623-21-013-5-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: "TRIANGLE" Sh.p.k. me adresë në Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RIPARIMI I OBJEKTEVE TË GJENDJES CIVILE**, me Numër të prokurimit: **623-21-1816-5-2-1**, Nr. i brendshëm: **623-21-013-5-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **11.06.2021**, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **RIPARIMI I OBJEKTEVE TË GJENDJES CIVILE**, me Numër të prokurimit: **623-21-1816-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-21-013-5-2-1**.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik: "TRIANGLE" Sh.p.k. me adresë në Suharekë, me datën: 16.06.2021 si palë e pa kënaqur ndaj Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës: 11.06.2021 ka paraqitur Kërkesë për Rishqyrtim sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042, për aktivitetin e prokurimit: **RIPARIMI I OBJEKTEVE TË GJENDJES CIVILE**, me Numër të prokurimit: 623-21-1816-5-2-1, Numër i brendshëm: 623-21-013-5-2-1, duke supozuar se janë shkelur dispozitat e Nenit 1, 6, 7, 59, 60 dhe 72 të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues me datë: 17.06.2021 brenda afatit ligjor ka shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës ku ka konstatuar si vijon:

Qëndrojnë arsyet e eliminimit nga Autoriteti Kontraktuese dhe se oferta e Operatorit Ekonomik: "TRIANGLE" Sh.p.k. me adresë në Suharekë, është e papërgjegjshme administrativisht.

Baza Ligjore të kërkesës

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR:

Lidhur me pretendimin tuaj se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 72 të LPP-së, nenin 39.1 të Rregullave të UOPP për vleruar tenderin në mënyrë të drejtë ju është dashur të kërkonit sqarime shites, diploma është dokument i pandryshueshëm dhe është dashur të kërkohej e noterizuar të jetë para datës së dorëzimit të ofertave dhe me këtë rastë ne kemi një vendim për menaxherin e projektit dhe ua kishim bashkëngjitur edhe dokumentet tjera sipas ligjit dhe konform rregullave e jo të na diskriminoni siq na keni diskriminuar.

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar, pasi që me datë: 11.06.2021 me Letër standrade për tenderuesin e eliminuar, kemi cekur:

Ju si Operatorë Ekonomik keni dhënë një deklaratë me shkrim për caktimin e menaxherit të projektit, Inxhinier i Diplomuar Ndërtimtarisë ose master – Drejtimi Konstruktiv, z. Remzi Javori, por në Ofertën e juaj lidhur me këtë Inxhinier është Dorëzuar vetëm deklaratë me shkrim për caktimin e menaxherit të projektit, ndërsa Mungojnë i gjithë dokumentacioni si në vijim:

- **Diplomat përkatëse – Kopje të noterizuar;**
 - **CV-në (të nënshkruar nga vetë pala);**
 - **Kontrata valide ose Para-kontrata e punës për stafin profesional;**
 - **Letër referencë për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit;**
- Andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së**

Sipas paragrafit 2 të nenit 51 të LPP-së, në asnjë rast nuk do të kërkohej nga Operatori Ekonomik që të dorëzojë dokumentet ose informatat që nuk kërkohej ose nuk janë në përputhshmëri me nenet 65-70 të këtij ligji.

Neni 72 paragrafi 3 i LPP-së informacioni plotësues për dokumentet ekzistenca e të cilave është fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e ofertave

Ne si Autoriteti Kontraktues nuk mund të kërkojmë nga Operatori Ekonomik, të plotësojë me dokumenta që nuk lejohen sipas nenit 69 dhe rrjedhimisht dokumentet e tilla pas datës së hapjes janë të papranueshme për Autoritetin Kontraktues sepse janë në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik.

Andaj pretendimet tuaja janë të pabazë se ne nuk ju kemi trajtuar në baze të Nenit 7, 10 dhe 59 të LPP-së, sepse vlerësimi i ofertave është bërë në mënyrë të drejtë konform Nenit 59 të LPP-së.

Oferta juaj në këtë aktivitet të prokurimit në bazë të dëshmive tregon se nuk jeni palë me interes sipas Nenit 4.1.26 të LPP-së, pasi që oferta juaj nuk është e përgjegjshme administrativisht.

Nga konstatimet e lartëcekur u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi të AK-së ju munde të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Me respekt:
Zyra e Prokurimit
Komuna e Rahovecit

Data: 17.06.2021